



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

RREGULLORE NR. ____/____,
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORËS NR. 01/2022
PËR
ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATËS
KOMUNALE

Tetor, 2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. / _____, dt. _____
Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Rregullorës (MAPL) Nr. 02-2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin të Akteve të Komunës, nenin 13, paragrafi 1.3 Nr 02-060/01-0056607/20-4 dt.24.09.2020 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë _____, miraton këtë:

RREGULLORE NR. ____ / _____,
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORËS NR. 01/2022
PËR
ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATËS
KOMUNALE

Tetor, 2024

Neni 1

Kjo Rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.

Neni 2

Neni 2, paragrafi 2 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:

2. Komuna kryen punë dhe detyra përmes drejtorive të administratës komunale, zyrave, njësive, sektorëve dhe institucioneve vartëse të saj, të përcaktuara me këtë Rregullore dhe dispozitave pozitive.

Neni 3

Nenit 4, të Rregullores bazë i shtohet një paragrafi i ri, dhe atë paragrafi 6 si në vijim:

5. Me punën e Institucioneve vartëse udhëheq Drejtori i Institucionit, dhe puna e tij është e rregulluar me ligjet dhe aktet nënligjore dhe me Statutin e Institucionit.

Neni 4

Neni 8, paragrafi 1.10 i Rregullores bazë fshihet në tërësi.

Neni 5

Neni 18 i Rregullores bazë fshihet në tërësi.

Neni 6

Neni 19, tek paragrafi 1.12 i Rregullores bazë fshihet emërtimi “Pyjeve”:

Neni 7

Pas nenit 23, tek Rregullorja bazë shtohet një nen i ri, neni 23A, si në vijim:

Neni 23A

Sektori i Arkivës

1. Sektori i arkivës kryen këto detyra dhe përgjegjësi:

Neni 8

Neni 28, tek paragrafi 1.2 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:

1.2 Sektori për Administratë në Shëndetësi.

Neni 9

Neni 30, i Rregullores bazë emërtimi “Sektori për Administratë dhe Financa në Shëndetësi” zëvendësohet me fjalinë “Sektori për Administratë në Shëndetësi”.

Neni 10

Neni 32, tek paragrafi 1.2 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:

1.2 Sektori për Administratë në Arsim.

Neni 11

Neni 33 shtohet një paragraf i ri, paragrafi 1.18:

1.18 Në bashkëpunim me drejtorin e DKA-së dhe sektorin për administratë përpunon kërkesat dhe nevojat e shkollave për stafin edukativo arsimor dhe mbështetës dhe në bashkëpunim me sektorin e administratës planifikojnë konkurset e rregullta dhe plotësuese në fillim të vitit shkollor, për vitin vijues shkollor.

Neni 12

Neni 34, i Rregullores bazë emërtimi “Sektori për Administratë dhe Financa në Arsim” zëvendësohet me fjalinë “Sektori për Administratë në Arsim”, dhe këtij neni i shtohet paragrafi 1.10:

1.10 Në bashkëpunim me drejtorin e DKA-së dhe sektorin për arsim përpunon kërkesat dhe nevojat e shkollave për stafin edukativo arsimor dhe mbështetës dhe në bashkëpunim me sektorin e administratës planifikojnë konkurset e rregullta dhe plotësuese në fillim të vitit shkollor, për vitin vijues shkollor.

Neni 13

Neni 75 i Rregullores bazë, fshihet emërimi “Pyjeve”.

Neni 14

Neni 78 i Rregullores bazë fshihet në tërësi.

Neni 15

Pas neni 89 shtohen 2 nene të reja dhe atë:

Neni 89A

Sektori i Shërbimeve Sociale

1. Sektori i shërbimeve sociale kryen këto detyra dhe përgjegjësi:

Neni 89B

Sektori i Skemës së Ndhimave Sociale

1. Sektori i skemës së ndihmave sociale kryen këto detyra dhe përgjegjësi:

Neni 16

Kjo rregullore shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA